



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Regj. Them. 14406/8877/4462 (31004-02615-86-2017)

Nr. Vendimit 2730

Data e regjistrimit 24.05.2017

Data e vendimit 17.10.2019

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

Lindita SINANAJ	KRYESUESE
Artur MALAJ	ANËTAR
Rilinda SELIMI	ANËTARE

Asistuar nga *sekretare gjyqësore* [REDAKTUAR] në Tiranë, sot më datë 17.10.2019, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative, që i përket palëve:

PADITËSE: *Bashkia Kavajë*

I PADITUR: *Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi*

OBJEKTI: Shfuqizimin e vendimit Nr. 203, datë 29.12.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32, 42, 43, 153, 154, 157, 202, 206 e vijues të Kodit të Proçedurës Civile; nenet 16 e vijues të ligjit Nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”; nenet 128 e vijues të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i

Procedurave Administrative”; ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”; neni 9 i ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Kreu 5 i Udhëzimit Nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore edukative, numri i nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar” të ndryshuar, ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 1305, datë 30.03.2017, ka vendosur:

- Kthimin e akteve paditësit Bashkia Kavajë.
- Ky vendim është i ankimueshëm në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 ditëve, afat i cili fillon nga e nesërmja e marrjes dijeni për vendimin.

Kundër vendimit nr. 1305, datë 30.03.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka paraqitur ankim pala paditëse, Bashkia Kavajë, që kërkon prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, duke parashtruar këto shkaqe:

- Sipas nenit 467 të Kodit të Proçedurës Civile, pika “c”, i kërkojmë Gjykatës Administrative të Apelit prishjen e vendimit Nr. 1305(80-2017-1313), datë 30.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po asaj gjykate, pasi ka vendosur pushimin e çështjes në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga ky Kod. Kjo kërkesë bazohet gjithashtu edhe në nenet 50 dhe 54 të ligjit Nr. 49/2012.
- Bashkia Kavajë, i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për gjykimin e mosmarrëveshjes administrative të lindur ndërmjet saj dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka pranuar për shqyrtim mosmarrëveshjen dhe me anë të fletëthirrjes, jemi njoftuar për datën e seancës së veprimeve përgatitore e cila ishte caktuar të mbahej më datë 17.03.2017. Ditën e seancës së veprimeve përgatitore, juristja e autorizuar e Bashkisë Kavajë, ka kërkuar që seanca të shtyhet pasi në të njëjtën ditë ajo duhet të ishte e pranishme në një komision të ngritur për proçedurat e pranimit në shërbimin civil.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kësaj kërkesë për shtyrjen e seancës gjyqësore dhe seanca është shtyrë për në datën 30.03.2017.

- Në seancën e datës 30.03.2017, nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur pushimi i çështjes me arsyetimin se nga ana e palës paditëse nuk është paguar taksa mbi aktet si kusht formal për ekzistencën e padisë.
- Vendimi i pushimit të çështjes dhe kthimit të akteve paditësit, është marrë nga gjykata duke mos marrë parasysh arsyet e mospagimit të taksës mbi aktet.
- Bashkisë Kavajë, nuk i është njoftuar detyrimi për pagimin e taksës mbi aktet jo gjatë seancës së veprimeve përgatitore, në kundërshtim me detyrimin që rëndon mbi gjykatën për këtë njoftim sipas nenit 154/a, pika 2 të Kodit të Proçedurës Civile. Në kushtet kur Bashkia Kavajë nuk ka marrë dijeni për këtë detyrim, ajo nuk ka pasur mundësi efektivisht për pagimin e taksës mbi aktet.
- Bashkia Kavajë, njeh detyrimin e saj për pagimin e taksës mbi aktet për fillimin e shqyrtimit të çështjes dhe do ta kishte përmbushur këtë detyrim nëse çështja nuk do të ishte pushuar.
- Nga ana e Gjykatës nuk jemi njoftuar për pagimin e taksës mbi aktet. Gjykata duhej të merrte një vendim për plotësimin e të metave të padisë dhe lënien e një afati për plotësimin e tyre, në kundërshtim me parashikimet e nenit 154/a të Kodit të Proçedurës Civile.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtares Lindita Sinanaj, shqyrtoi aktet e dosjes dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

1. Rrethanat e çështjes.

Paditësi, Bashkia Kavajë, i është drejtuar Gjykatës Administrative Tiranë me kërkesëpadi kundër palës së paditur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke kundërshtuar vendimin Nr.

203, datë 29.12.2016 të palës së paditur. Gjyqtari i caktuar me short për gjykimin e çështjes, ka caktuar zhvillimin e seancës përgatitore në datën 17.03.2017, seancë e cila rezulton të jetë zhvilluar në mungesë të palës paditëse Bashkia Kavajë, në kushtet kur është njoftuar rregullisht për ditën dhe orën e zhvillimit të seancës dhe nuk ka paraqitur shkak për mosparaqitjen. Në këtë seancë konstatohet se gjyqtari i çështjes ka evidentuar të meta në kërkesëpadinë e paraqitur, e konkretisht nuk ishte paguar taksa gjyqësore. Në këto rrethana me vendim të ndërmjetëm ka disponuar komunikimin palës paditëse të të metës së konstatuar të padisë duke lënë kohë për plotësimin e saj deri në seancën gjyqësore e cila është caktuar për t'u zhvilluar në datën 30.03.2017 ora 10.45.

Me fletë-thirrjen e datës 17.03.2017 drejtuar palës paditëse Bashkia Kavajë, me të cilën pala paditëse është njoftuar për zhvillimin e seancës gjyqësore në datën 30.03.2017, pala paditëse njëherësh është njoftuar edhe për plotësimin e të metës së padisë. Fletëthirrja rezulton ti jetë komunikuar palës paditëse në datën 23.03.2017.

Në seancën gjyqësore të datës 30.03.2017 pala paditëse rezulton të mos jetë paraqitur e njëherësh nuk është plotësuar edhe e meta e konstatuar e padisë. Në këto rrethana gjykata ka disponuar kthimin e padisë.

2. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në vlerësim të situatës, kur në datën e seancës së radhës, datë 30.03.2017, të metat e konstatuara të padisë lidhur me pagimin e taksës gjyqësore, nuk rezultoi të ishin plotësuar, bazuar në parashikimet e neneve 154/a të Kodit të Proçedurës Civile dhe 25/1, germa "a" të ligjit nr. 49/2012, gjykata ka konkluduar se aktet duhet që ti kthehen palës paditëse.

3. Vlerësimi i çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit.

Gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7, germa "a", nenit 10, paragrafi 2, germa "a" dhe nenit 44 të ligjit Nr. 49/2012, kjo Gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

Në vlerësim të kushteve të pranueshmërisë së ankimit, rezulton që vendimi nga gjykata e shkallës së parë është shpallur në datën 30.03.2017, kurse ankimi nga pala paditëse, Bashkia Kavajë është dërguar nëpërmjet shërbimit postar në datën 18.04.2017, pasi i është komunikuar vendimi në datën 12.04.2017. Duke patur parasysh që data 17.04.2017 ka qenë ditë pushimi, festa zyrtare e Pashkëve, konstatohet se ankimi është paraqitur brenda afatit pesë ditor, të përcaktuar në nenet 443, paragrafi i katërt dhe 444, paragrafi i parë të Kodit të Proçedurës Civile, si dhe nenit 25 pika 1 germa "a" të ligjit nr. 49/2012. Po kështu, nuk rezulton të ekzistojnë kriteret penguese të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr. 49/2012 që e bëjnë vendimin të paankimueshëm. Ankimi rezulton të jetë i plotë edhe në elementët e tjerë, si në elementët e formës edhe të përmbajtjes, lidhur me nënshkrimin nga pala që e ka paraqitur, tregimin e palëve ndërgjyqëse, vendimin kundër të cilit është paraqitur ankim, apo kërkimet për të cilat ai është paraqitur. Për të gjitha sa më sipër gjykata çmon se ankimi i paraqitur kundër vendimit Nr. 1305 (80-2017-1313), datë 30.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, objekt gjykimi, duhet të pranohet për shqyrtim.

Lidhur me pretendimet e parashtruara në ankim nga pala paditëse, referuar fakteve të mësipërme, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se janë të pabazuara në ligj e prova. Në analizë të pretendimeve të parashtruara në ankim dhe të proçedurës së zhvillimit të këtij gjykimi, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për kthimin e padisë dhe të akteve shoqëruese të saj, është marrë në zbatim të drejtë të nenit 25, pika 1, germa "a" të ligjit nr. 49/2012. Lidhur me elementët që duhet të përmbajë kërkesëpadi në fjalë, Gjykata i referohet dispozitave të ligjit nr. 49/2012 dhe Kodit të Proçedurës Civile. Konkretisht, në nenin 21 të ligjit nr. 49/2012 është sanksionuar se: "1. Padi duhet të plotësojë kërkesat e neneve 154 e 156 të Kodit të Proçedurës Civile.

Përveç këtyre kërkesave, paditësi në padi duhet të tregojë saktë:

a) adresën e tij ose të përfaqësuesit, në të cilën duhet t'i dërgohen nga gjykata njoftimet dhe aktet;

b) një numër telefoni të tij ose të përfaqësuesit, në të cilin gjykata mund ta njoftojë, një adresë elektronike të tij ose të përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, si dhe deklaratën e pranimit të njoftimit me telefon ose në mënyrë elektronike.

2. Paditësi, përveç aktit administrativ që kundërshton, nuk ka detyrim t'i bashkëlidhë padisë akte provuese, por, nëse i paraqet ato, duhet të paraqesë edhe kopje të tyre për të paditurin.”

Kurse në nenin 156 të Kodit të Procedurës Civile është parashikuar se:

“Bashkë me kërkesëpadinë duhet të paraqiten:

- a) Prokura, në rast se kërkesëpadia paraqitet në emër të paditësit nga përfaqësuesi i tij;*
- b) Kopje të kërkesëpadisë dhe të akteve provuese në numër sa janë të paditurit, si dhe për rastin e parashikuar nga neni 197 i Kodit Civil.*

Me paraqitjen e kërkesëpadisë paguhet tarifa, si dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.”

Në vështrim të këtyre dispozitave rezulton se paditësi që investon gjykatën me kërkesëpadi midis të tjerave, ka detyrimin të paguajë tarifën dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet dhe shërbimet e tjera gjyqësore. Në çështjen objekt gjykimi, në analizë të parashikimeve ligjore të cituara më sipër, si dhe të akteve shkresore që i janë bashkangjitur kërkesëpadisë, kjo Gjykatë vlerëson të drejtë disponimin e gjykatës së shkallës së parë, së pari lidhur me caktimin e afatit për plotësimin e të metave dhe së dyti, për kthimin e padisë në kushtet kur nga pala paditëse nuk u plotësuan të metat e konstatuara. Pretendimi i palës paditëse se nuk është njoftuar për plotësimin e të metave të padisë dhe pagimin e taksës gjyqësore konstatohet të jetë i pabazuar në kushtet kur në fletë-thirrjen nr. 1819 akti, datë 17.03.2017 drejtuar palës paditëse rezulton të jetë vendosur shënimi lidhur me detyrimin e kësaj pale për të paguar taksën gjyqësore deri në datën e caktuar për zhvillimin e seancës gjyqësore. Fletë-thirrja përkatëse rezulton ti jetë komunikuar rregullisht palës paditëse në datën 23.03.2017 nga nëpunësi i shërbimit postar, në kushtet kur është nënshkruar si nga punonjësit e palës paditëse ashtu edhe nga nëpunësi i shërbimit postar.

Për sa më sipër, në kushtet kur rezultoi e provuar në gjykim se pala paditëse nuk ka plotësuar të metat e padisë brenda afatit të caktuar nga gjykata me vendimin e ndërmjetëm të datës 17.03.2017, vendim për të cilin ka marrë dënim rregullisht, kjo Gjykatë vlerëson të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë për kthimin e padisë, vendimmarrje kjo që është plotësisht e bazuar në parashikimet e bëra në nenin 25, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 49/2012, ku është parashikuar se: *“1. Për zhvillimin e gjykimit, sipas parimit të një procesi të rregullt*

gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, gjyqtari kryesues, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë, kryen këto veprime: a) I kërkon paditësit plotësimin e të metave të padisë, duke i caktuar atij një afat, deri në 10 ditë. Kur paditësi nuk plotëson të metat e padisë, brenda afatit të caktuar, gjyqtari jep vendim për kthimin e padisë dhe të akteve, që i bashkëlidhen asaj. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë". Për sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit vlerëson tërësisht të pabazuara në ligj e prova pretendimet e parashtuara në ankim nga pala paditëse dhe duke qënë se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në analizë të plotë e të hollësishme të rrethanave të faktit e të ligjit, referuar nenit 50 gërma "b" të ligjit nr.49/2012, kjo gjykatë vlerëson se duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenet 49 e 50, germa "b" të ligjit nr. 49/2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative".

VENDOSI

- Lënien në fuqi të vendimit Nr. 1305 (80-2017-1313), datë 30.03.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Kundër vendimit lejohet të ushtrohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi.

Tiranë më 17.10.2019.

ANËTARE
Rilinda SELIMI
dv

ANËTAR
Artur MALAJ
dv

KRYESUESE
Lindita SINANAJ
dv

Vertetohet njësia me origjinalin

Kancelari
Leonard Shkedy
Shkedy

